



Sa kushton bileta sezonale e nxënësve?

Bileta sezonale e nxënësve (pa pagesë gjatë kohës të vitit shkollor), mund të blihet për muajt korrik dhe gusht dhe kushton 600 den. për një muaj. Bileta mund të shfrytëzohet për të gjithë linjat (urbane dhe ndërrbane). Nuk nevojiten dokumente shtesë, por vetëm paraqitet karta e personalizuar "E SHKUPIT" e nxënësit.

Në biletën time mujore për udhëtim kam paguar 1.600 denarë, por e kam humbur. E ruaj llogarinë fiskale dhe desha të pyes nëse mund të nxjerr kartë të re "TË SHKUPIT" në të cilën do të më evidentohet shuma e paguar?

Pagesa e juaj tashmë është regjistruar në sistemin e NQP -SHKUP. Është e nevojshme që të blini kartë të re, që do ju kushtojë 200 denarë, kurse pagesa juaj për biletën mujore të udhëtimit prej 1.600 denarë të cilën e keni humbur, do të transferohet automatikisht në biletën e re mujore për udhëtim. Këtë mund ta bëni në çdo qendër për personalizim të NQP Shkup.

Gjatë udhëtimit me NQP e kam harruar çadrën. Ku mund të drejtohem dhe të pyes nëse është gjetur nga shoferi?

Nevojitet që të drejtoheni në shërbimin e NQP E humbur – e gjetur, në tel. 3122 634.

Në rast se keni humbur diçka në automjetin e transportuesve privat, drejtoheni në qendrën dispeçere të transportuesve privat në tel. 2602 015.

Kam biletë vjetore, por nuk e kam shfrytëzuar disa muaj dhe e kontrollova në biletari dhe mora përgjigje se është e vlefshme. Gjatë përpjekjes që të validojë aparatën në autobus është paraqitur porosia se bileta nuk është e vlefshme. Nuk do të dëshiroja që të përballem me dënim, por nuk e di se ku të drejtohem?

Drejtoheni në një nga qendrat për personalizim apo drejtëpërdrejtë në Drejtorinë e NQP në Autokomandë.

Kam fëmijë me nevoja të veçanta. Fëmija zotëron dy karta – një për të dhe një për shoqëruesin e tij. A mundem si shoqërues të shfrytëzojë kartën edhe kur nuk jam me fëmijën, por kur shkojë që ta marr nga pishina, qendra ditore etj.?

Bileta për shoqërues mund të përdoret vetëm kur jeni me fëmijën.



Cili është orari i punës i qendrave për personalizim?

Orari i punës është nga e hëna në të shtunë, prej orës 6 deri në ora 19.30.

INFORMATA PËR KONSUMATORËT

Linja telefonike pa pagesë: 080015115

Telefoni për kontakt: 02 3174264 / 02 3174 260

E-postë: kontakt@jsp.com.mk

E humbur e gjetur: 3122 634

www.jsp.com.mk, www.skopska.mk www.facebook.com/jspskopjee



KJO BROSHURË U PËRGATIT NGA:

KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE TË QYTETIT TË SHKUPIT

Bul. Ilinden, nr. 82- Shkup
potrosuvaci@skopje.gov.mk
<http://www.skopje.gov.mk>

ORGANIZATA E KONSUMATORËVË TË MAKEDONISË OKM - Shkup

Rr. Divizioni 50, 10A Shkup
 Për këshillim kontaktoni:

sovetuvanja@opm.org.mk, ose në platformën e këshillimit
 në uebfaqen <http://www.opm.org.mk>



Qyteti i Shkupit



KËSHILLI PËR MBROJTJE
TË KONSUMATORËVE



CILAT JANË TË DREJTAT dhe DETYRIMET E KONSUMATORËVE GJATË SHFRYTËZIMIT TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK

Jeni duke pritur autobusin në stacionin e autobusit, kurse në tabelën informuese elektronike është shënuar se arrin për dy minuta. Megjithatë, autobusi nuk arrin në kohën e shënuar, kurse tabela informuese nuk tregon një orar tjetër të arritjes. Në ndërkohë ju vonoheni në punë dhe nuk e dini nëse autobusi megjithatë do të arrijë apo nuk do të paraqitet fare.

Në biletari e keni mbushur kartën tuaj me dhjetë udhëtime dhe për atë keni llogari fiskale. Hyni në autobus, e validoni kartën dhe e shihni se ju kanë mbetur 4 udhëtime, dhe jo 9 siç do të duhej.

Do të dëshironi të shkoni me transport të autobusit në Vodno, por nuk jeni të sigurtë me cilin numër të autobusit të shkoni dhe nëse ai funksionon.

Keni hypur në autobus dhe pas disa stacioneve ndjeni aromë të pakëndshme të tymit. Ju reagoni, kurse shoferi përpiqet që të rregullojë vetë defektin. Nuk ka sukses dhe i zbret të gjithë udhëtarët që të presin autobusin tjetër. Ju tashmë jeni vonë për të arritur në destinacionin e dëshiruar, por jo për fajin tuaj.

Në të gjithë situatat e përmendura, si shfrytëzues të shërbimit duhet të reagoni, sepse detyrimi ynë, si konsumatorë është krahas pagesës të biletës për udhëtim të reagojmë edhe për të gjithë parregullsitë





të cilat paraqiten gjatë transportit publik me autobus të Qytetit të Shkupit. Vetëm kështu do të kontribuojmë që të kemi linja të rregullta të autobusit dhe informata në kohë për arritjen e autobusit, leximin e saktë të numrit të udhëtimeve dhe transportin cilësorë publik me autobus.

Mendimi ynë është i rëndësishëm dhe duhet ta themi, duhet të shtojmë pyetje dhe të ankojemi nëse janë shkelur të drejtat tona apo nëse nuk jemi të informuar mirë.

PËR TË GJITHË PYETJET NË LIDHJE ME: LINJAT JO TË RREGULLTA TË AUTOBUSIT, PROBLEMET ME KARTAT ELEKTRONIKE, HIGJENËN NË AUTOBUSA, RAPORTIN E PASJELLSHËM TË KONTROLLUESVE, SHOFERËT, BILETARËT, AUTOBUSËT E PRISHUR, MUND TË DREJTOHENI DERI TE SHËRBIMET TË NDËRMARRJES E QARKULLIMIT PUBLIK – Shkup DHE TRANSPORTUESIT PUBLIK.

RREGULLAT THEMELORE PËR SJELLJEN E UDHËTARËVE

Siguria e udhëtarëve gjatë hyrjes dhe daljes nga automjeti

- Hyrja dhe dalja janë të lejuara vetëm në vendet e caktuara (stacionet e autobusit), vetëm përderisa automjeti nuk është në lëvizje.
- Gjatë hyrjes në automjet, nevojitet që në fillim të lirohet vendi për ato të cilët dalin.
- Gjatë hyrjes apo daljes nga automjeti, udhëtari duhet të mbajë fortë parmakun që të shmanget humbja e ekuilibrit. Udhëtarët, gjatë transportit, duhet të mbahen te dorezat dhe vendet tjera përkatëse që janë dedikuar për atë qëllim.
- Gjatë hyrjes apo daljes nga automjeti, udhëtarët duhet të kujdesen për distancën ndërmjet automjetit dhe trotuarit. Fëmijët të cilët nuk janë karrocë gjithmonë duhet të mbahen për dore.
- Si udhëtarë asnjëherë mos mbështeteni te dyert dhe dritaret – kjo mund të shkaktojë lëndime serioze.
- Mbajtja në rregull e maskës për mbrojtjen personale dhe mbrojtjen e udhëtarëve tjerë nga Covid 19.

Udhëtarëve gjatë hyrjes në autobus nuk u lejohet:

- Pengimi i personit përgjegjës në kryerjen e punës të tij.



- Mbajtja në automjet në mënyrë që pengon validimin e biletave dhe hyrjen dhe daljen nga automjeti.
- Pamundësimi i hapjes dhe mbylljes të dverve, si dhe hapja e tyre me forcë.
- Hyrja dhe dalja nga automjeti derisa është në lëvizje.
- Hedhja e mbeturinave.
- Dëmtimi i automjetit.
- Pirja e duhanit në automjet.
- Konsumi i ushqimit dhe pijeve.
- Futja e biçikletës, hyrja me patina, rrëshqitëse, trotinet.

BILETA E AUTOBUSIT

Të gjithë udhëtarët gjatë kohës të udhëtimit duhet të zotërojnë biletë të rregullt të VALIDUAR NË RREGULL, DHE JANË TË DETYRUAR QË TË TREGOJNË BILETËN GJATË KONTROLLIT TË LINJËS (KONTROLLUESIT) APO PERSONIT TJETËR TË AUTORIZUAR ZYRTAR.

Gjatë hyrjes në automjete, mos harroni që të validoni kartën tuaj, në të kundërt do të konsiderohet se nuk zotëroni biletë dhe në rast të kontrollit do ju lëshohet procesverbal për biletë shtesë (ndëshkuese).

Nëse zotëroni kartë të personalizuar „TË SHKUPIT“ mund ta shfrytëzoni vetëm ju, respektivisht personi në emër të së cilit është lëshuar. Ajo nuk mund të bartet dhe rrezikoni që ajo t'ju merret dhe të paguani dënim. NË RAST SE DO TA HUMBNI DHE PARAQISNI NË SHËRBIMIN PËRKATËS NË NQP, AJO DO TË BLOKOHET NË MËNYRË SISTEMORE, NDËRSA MJETET/EVENTUALE TË PASHFRYTËZUARA, DO JU TRANSFEROHEN NË KARTËN E RE (KOPJE) TË PERSONALIZUAR „TË SHKUPIT“.

Karta jo e personalizuar e „E SHKUPIT“ mund të bartet, kurse përparësia qëndron në atë që mund të shfrytëzohet nga më shumë persona dhe mund të ketë funksion të kartës familjare. NË RAST SE DO TA HUMBNI, AJO NUK MUND TË BLOKOHET, DHE AS MJETET/



BILETAT E PASHFRYTËZUARA EVENTUALE NUK MUND TË TRANSFEROHEN NË KARTËN TJETËR JO TË PERSONALIZUAR „TË SHKUPIT“.

- ◆ Nëse NUK ZOTËRONI kartë „TË SHKUPIT“, biletën mund të blini/validoni përmes SHËRBIMIT MOBIPAY, respektivisht me telefon mobil. PËR INFORMATA MË TË HOLLËSISHME, DREJTOHUNI TE OPERATORI JU AJ I TELEFONIT MOBIL.
- ◆ Biletën për një udhëtim mund të bleni edhe drejtëpërdrejtë te shoferi i autobusit apo në vendin ku shiten biletat në NQP Shkup.
- ◆ Mundeni thjeshtë që të shkarkoni aplikacionin „E SHKUPIT“ përmes „play store“ në telefonin mobil. Me atë do të mundeni që në mënyrë elektronike:

- Të mbushni mjete/bileta në kartën tuaj „TË SHKUPIT“;
- Në çdo kohë të kontrolloni gjendjen në kartën tuaj „TË SHKUPIT“;
- „onlajn“ të bleni biletë elektronike për një udhëtim në vend se të bleni biletën te shoferi apo ta paguani me telefon mobil (që do ju kushtojë më shtrenjtë);
- Ekzistojnë edhe funksione të tjera (kontrolli i rendit të udhëtimit, hartës të planifikimit, kontrolli i stacioneve të autobusit dhe të ngjashme).

Pyetje të shtrura më shpesh

Ku mund të bleni biletën mujore për udhëtim dhe cili dokumentacion nevojitet që të paraqitet?

Bileta mujore për udhëtim mund të blihet/mbushet vetëm në kartën e personalizuar „TË SHKUPIT“ në Qendrën për personalizim të NQP Shkup. Bileta kushton 1.400 den. për linjat në qytet dhe 1.600 den. për të gjithë linjat (linjat urbane dhe ndërrbane). Nëse personi nuk zotëron kartë të personalizuar „TË SHKUPIT“, do të duhet të paguajë edhe kompenzim të njehershëm në lartësi prej 200 den për kartë „TË SHKUPIT“. Nevojitet letërnjoftim apo çfarëdo dokumenti tjetër personal për identifikim personal.

Mbushja e biletës të blerë mujore bëhet në çdo vend për shitje të NQP Shkup (biletaria dhe Qendra për personalizim), si dhe në rrjetin shitës dytësorë (trafika, dyqane).

